

RREGULLAT E PROMOCIONIT

„TV Dual Screen“

Data e publikimit të rregullave të fushatës promovionale: 13.10.2025.

1. ORGANIZATORI I PROMOCIONIT, PAJISJET E PËRFSHIRA NË PROMOCION

Samsung Electronics Austria GmbH, Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri (në tekstin e mëtejshëm: „Samsung“) organizon fushatën promovionale për blerësit e televizorëve Samsung të përmendur në pikën 3 të këtyre Rregullave, të cilët në vazhdim të këtij teksti veçmas quhen „Pajisje“ dhe së bashku „Pajisjet“.

2. PJESËMARRËSIT NË PROMOCION, PERIUDHA PROMOCIONALE

Fushata promovionale është e disponueshme për persona fizikë dhe juridikë (blerësit fundorë – konsumatorët), që kanë adresë për dorëzimin e Pajisjeve të blera në territorin e Republikës së Kosovës, të cilët nuk i blejnë Pajisjet me qëllim rishitjeje dhe që plotësojnë të gjitha kushtet e tjera të përcaktuara me këto Rregulla.

Kohëzgjatja e fushatës promovionale në lidhje me Pajisjet është nga data 13.10.2025 deri më 9.11.2025 ose deri në përfundim të stokut të Pajisjeve ose dhuratave të parashikuara për këtë promovion. Sasia e dhuratave që janë objekt i kësaj fushate promovionale është e kufizuar.

3. PËRFITIMET E PROMOCIONIT

Kjo fushatë promovionale u mundëson pjesëmarrësve që në periudhën promovionale nga 13.10.2025 deri më 9.11.2025, tek partnerët e shitjes të Samsung të përmendur në pikën 5 të këtyre Rregullave, të blejnë një nga televizorët Samsung të listuar në tabelën më poshtë dhe, me kusht regjistrimi për fushatë sipas këtyre Rregullave dhe plotësimit të të gjitha kushteve të tjera të përcaktuara, të fitojnë të drejtën për një televizor tjetër Samsung sipas tabelës më poshtë.

Emërtimi i pajisjes që është objekt i kësaj fushate	Madhësia e ekranit (në inç)	Kodi i modelit të Pajisjes që është objekt i kësaj fushate	Emërtimi i pajisjes dhuratë përkatëse	Kodi i modelit të pajisjes dhuratë përkatëse
QN9	98	QE98QN90DATXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
QN9	98	QE98QN90FATXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
8K	85	QE85QN900FTXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
QN80	85	QE85QN80FAUXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
QN9	85	QE85QN90FATXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
S85	83	QE83S85FAEXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
S90	83	QE83S90FAEXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
S95	83	QE83S95FAEXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH

S85	77	QE77S85FAEXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
S90	77	QE77S90FAEXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
S95	77	QE77S95FATXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
8K	75	QE75QN900FTXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
8K	75	QE75QN990FTXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
QN80	75	QE75QN80FAUXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
QN85	75	QE75QN85FAUXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
QN9	75	QE75QN90FATXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
8K	65	QE65QN900FTXXH	TV 24" full HD smart TV	UE24F6002FKXXH
8K	65	QE65QN990FTXXH	TV 24" full HD smart TV	UE24F6002FKXXH
QN80	65	QE65QN80FAUXXH	TV 24" full HD smart TV	UE24F6002FKXXH
QN85	65	QE65QN85FAUXXH	TV 24" full HD smart TV	UE24F6002FKXXH
QN9	65	QE65QN90FATXXH	TV 24" full HD smart TV	UE24F6002FKXXH
S85	65	QE65S85FAEXXH	TV 24" full HD smart TV	UE24F6002FKXXH
S90	65	QE65S90FATXXH	TV 24" full HD smart TV	UE24F6002FKXXH
S95	65	QE65S95FATXXH	TV 24" full HD smart TV	UE24F6002FKXXH
QN80	100	QE100QN80FUXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
Frame	75	QE75LS03FWUXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
Frame	65	QE65LS03FAUXXH	TV 24" full HD smart TV	UE24F6002FKXXH
Frame	65	QE65LS03FWUXXH	TV 24" full HD smart TV	UE24F6002FKXXH
Q80	98	QE98Q80CATXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
UHD	98	UE98DU9072UXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
Micro RGB	115	MRE115MR95FXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH
QN9	115	QE115QN90FTXXH	Gift TV 27" full HD smart TV	UE27F6002FKXXH

SHËNIME:

Partnerët shitës të Samsung të përmendur në pikën 5 të këtyre Rregullave caktojnë në mënyrë të pavarur çmimet me pakicë të Pajisjeve që janë objekt i kësaj fushate, prandaj çmimet me pakicë mund të ndryshojnë në varësi të partnerit ku janë blerë Pajisjet.

4. KUSHTET E TJERA PËR PJESËMARRJE DHE PËRFITIM NGA FUSHATA

Për të realizuar të drejtën e pjesëmarrjes në këtë fushatë dhe përfitimet e saj, duhet të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Pajisja të jetë blerë vetëm gjatë periudhës promovionale të përcaktuar në pikën 2 të këtyre Rregullave, vetëm tek një nga partnerët shitës të Samsung në territorin e Republikës së Kosovës të listuar në pikën 5.
- Pajisja të jetë blerë nga përdoruesi fundor – person fizik ose juridik që ka adresë për dorëzim në territorin e Republikës së Kosovës dhe që e ka blerë për nevojat e veta, jo për rishitje apo shpërndarje.
- Blerësi të regjistrohet për pjesëmarrje në fushatë deri më 9.12.2025 përmes faqes së internetit: <https://www.samsung.com/al/offer/redemption/double-tvs-for-your-enjoyment-2025-xk> dhe të japë të dhënat/dokumentet e mëposhtme:
 - emrin dhe mbiemrin e blerësit – pjesëmarrësit,
 - adresën e email-it të blerësit – pjesëmarrësit (për njoftim të regjistrimit),
 - adresën e saktë të banimit (për dorëzimin e dhuratës),
 - numrin e telefonit (për dorëzimin e dhuratës),
 - kopjen (scan) e faturës fiskale të lëshuar në vendin e shitjes për blerjen e Pajisjes nga pika 3,
 - modelin dhe numrin serial të Pajisjes së blerë sipas pikës 3.

Regjistrimet e vonuara do të refuzohen automatikisht.

Dërgimi i të dhënave, pra aplikimi për pjesëmarrje, do të thotë që blerësi pranon këto Rregulla. Në rast të një aplikimi të suksesshëm, të saktë, në kohë dhe të plotë, dhe nëse janë përmbushur të gjitha kushtet, dhurata sipas pikës 3 do të dërgohet tek pjesëmarrësi brenda 150 ditëve nga afati i fundit për aplikim, në adresën e dhënë në Republikën e Kosovës.

SHËNIM:

Të drejtën për dhuratën e përcaktuar nga këto Rregulla do ta ketë personi i parë që regjistron me sukses dhe në mënyrë të plotë numrin serial të Pajisjes së blerë. Çdo aplikim i mëvonshëm nuk do të merret parasysh.

Kjo e drejtë nuk mund të kombinohet me dhurata nga fushata të tjera të Samsung.

Ngjyra e pajisjes dhuratë varet nga disponueshmëria dhe nuk mund të zgjidhet nga blerësi.

5. LISTA E PARTNERËVE TË AUTORIZUAR SHITËS SAMSUNG

- AZTECH Electronics
- Neptun - Home

6. DORËZIMI I PAJISJEVE TË BLERA

Afatet dhe kushtet e dorëzimit të Pajisjeve të blera gjatë periudhës së fushatës përcaktohen në mënyrë të pavarur nga secili partner shitës i përmendur në pikën 5.

7. DETYRIMI PËR KTHIMIN E DHURATËS NË RASTIN E PËRDORIMIT TË SË DREJTËS PËR KTHIMIN E MALLRAVE NË BLERJET ONLINE

Nëse pjesëmarrësi që ka blerë Pajisjet online përfiton nga e drejta ligjore e kthimit, është i detyruar të kthejë edhe dhuratën e marrë nga kjo fushatë promovionale.

Për kthim, pjesëmarrësi duhet të kontaktojë Samsung në email-in: ce.promotion@samsung.com. Pas marrjes së email-it, Samsung do ta informojë mbi adresën ku duhet të dërgojë dhuratën.

8. E DREJTA E NDRYSHIMIT TË RREGULLAVE

Samsung ruan të drejtën që në çdo kohë, për arsye të justifikuara, të bëjë ndryshime në këto Rregulla, me detyrimin që ato të publikohen menjëherë.

9. KONTAKT

Adresa e email-it për kontakt në lidhje me këtë fushatë promovionale: ce.promotion@samsung.com

NJOFTIM PËR MBLEDHJEN DHE PËRDORIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Samsung Electronics Austria GmbH, me seli të regjistruar në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri (në vijim: "Përpunuesi") ju njofton me këtë rast për informacionet në lidhje me përpunimin e të dhënave personale:

1. Kontrolluesi i të dhënave

Përpunuesi i të dhënave është Samsung Electronics Austria GmbH, me seli të regjistruar në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri, përmes Degës së vet Samsung Electronics Austria GmbH Beograd (në vijim: "**Kontrolluesi**").

2. Të dhënat që mbliidhen

Përpunuesi do të mbledhë dhe përpunojë të dhënat e mëposhtme personale:

- Emri dhe mbiemri,
- Adresa e emailit e blerësit,
- Adresa e blerësit (për qëllime të dorëzimit të dhuratës),
- Numri serial i pajisjes së blerë,

- Të dhëna për blerjen – fatura/fletë-dërgesa,
- Dëshmi për marrjen/pranimin e pajisjes së blerë,

(në vijim së bashku: **Të dhëna personale**).

3. Qëllimi i mbledhjes së të dhënave personale

Kontrolluesi do të mbledhë dhe përpunojë të dhënat personale të mësipërme ekskluzivisht për qëllime të përcaktimit të përmbushjes së kushteve për pjesëmarrje në promocion, si dhe për dorëzimin e dhuratës në rast se përdoruesi/blerësi ka fituar të drejtën për të.

4. Mënyra e përdorimit të të dhënave personale

Të dhënat personale që mblidhen mbi bazën e pëlqimit do të përdoren ekskluzivisht për qëllimet e sipërpërmendura të Kontrolluesit, dhe në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (Ligji) dhe Politikën e privatësisë të Kontrolluesit të bashkëngjitur më poshtë.

5. Baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale

Të dhënat personale përpunohen dhe mblidhen nga Përpunuesi mbi bazën e pëlqimit vullnetar të personit që i përket të dhënat.

6. Afati i ruajtjes së të dhënave personale

Të dhënat personale do të ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit të përmendur, dhe në çdo rast jo më gjatë se 6 muaj nga data e blerjes.

7. Të drejtat tuaja

Kontrolluesi i të dhënave personale, me kërkesë të blerësit, do të plotësojë, ndryshojë, përditësojë ose fshijë të dhënat personale nëse të dhënat janë të paplota, të pasakta ose të papërditësuara, si dhe nëse përpunimi i tyre nuk është në përputhje me ligjin, ose nëse qëllimi i mbledhjes së të dhënave është përmbushur. Për më shumë informacion, ju lutemi shikoni Politikën tonë të privatësisë ose na kontaktoni duke dërguar një email në adresën: dataprotection.sead@samsung.com

Në rast se blerësit vlerësojnë se përpunimi i të dhënave të tyre personale cenon privatësinë e tyre, ata mund t'i drejtohen Kontrolluesit të të dhënave personale ose Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe të kërkojnë shpjegim.

8. Informacione të tjera

Për informacion të detajuar rreth masave të ndërmarra për ruajtjen e të dhënave personale si dhe për çdo mundësi të transmetimit të të dhënave personale, lexoni Politikën tonë të privatësisë.

POLITIKAT E PRIVATËSISË TË SAMSUNG ELECTRONICS AUSTRIA GMBH, DEGA NE ZAGREB

Në fuqi: Maj 2018

Samsung Electronics Austria GmbH, dega jonë në Zagreb dhe shoqëritë tona të lidhura ("Samsung", "ne", "ne", "tona"), jemi të ndërgjegjshëm mbi rëndësinë që ka privatësia për punëmarrësit, furnitorët, klientët dhe të gjithë të tjerët me të cilët ne punojmë, ndaj përpiqemi të jemi të qartë mbi mënyrën e mbledhjes, përdorimit, shpërndarjes, transferimit dhe ruajtjes së informacionin personal.

Çështjet kryesore të trajtuara nga Politika jonë e Privatësisë janë vijueset:

- 1. Shtrirja dhe Qëllimi**
- 2. Përgjegjësia e përputhshmërisë**
- 3. Përgjegjshmëria jonë**
- 4. Përkufizime**
- 5. Parimet e Rregullores për Mbrojtje të Përgjithshme të të Dhënave Personale**
- 6. Kategoritë e veçanta të të dhënave personale**
- 7. Shpërndarja e të dhënave personale (përfshirë transferimin e të dhënave jashtë vendeve të Zonës Ekonomike Europiane (EEA))**
- 8. Krijimi i profilit dhe vendimmarrja e automatizuar**
- 9. Marketingu i drejtpërdrejtë**
- 10. Mbajtja e regjistrave**
- 11. Të drejtat e subjekteve të të dhënave**
- 12. Shkelja e të dhënave personale**
- 13. Autorizimi për të hyrë në të dhëna**
- 14. Përditësimi i Rregullores**
- 15. Informacion i dobishëm kontakti**

1. Shtrirja dhe Qëllimi

Ky dokument përcakton rregullat e mbrojtjes së të dhënave personale dhe parashikimet ligjore që duhen respektuar, lidhur me përfitimin, trajtimin, përpunimin, ruajtjen, transferimin dhe shkatërrimin e të dhënave personale.

Llojet e të dhënave që ne mund të përpunojmë përfshijnë detaje informacioni të punonjësve, furnitorëve, blerësve dhe cilitdo me të cilin ne ndërveprojmë. Të dhënat e ruajtura në dokument shkresor, kompjuter ose media të tjera u nënshtrohen masave mbrojtëse ligjore të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ("GDPR") dhe ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat vendosin kufizime mbi mënyrën se si ne mund t'i përdorim të dhënat e përmendura.

Ruajtja e standardeve më të larta në trajtimin tonë të të dhënave personale është një përgjegjësi kolektive dhe individuale, dhe këto Rregulla zbatohen mbi metodat e marrjes, përdorimit, ruajtjes, fshirjes dhe formave të tjera të përpunimit të të dhënave personale që hasim në biznesin tonë. Ato përfshijnë një

përmbledhje gjithëpërfshirëse të detyrimeve kryesore për mbrojtjen e të dhënave, që na zbatohen kundrejt nesh si organizatë.

Kjo Politikë e Privatësisë zbatohet për të gjithë punonjësit e Samsung dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve për Samsung (duke përfshirë, por pa u kufizuar në kontraktorët dhe punonjësit e agjencive) (referuar së bashku si "Anëtarët e Stafit"). Të gjithë anëtarëve të stafit u kërkohet të sigurojnë që ata të kuptojnë dhe të respektojnë këto Rregulla lidhur me çdo informacion personal tek i cili ata kanë akses në fushën e punës së tyre.

Anëtarëve të Stafit do t'u kërkohet gjithashtu të marrin pjesë në trajnime lidhur me sa më sipër si dhe lidhur me politikat përkatëse, me kërkesë të Samsung.

2. Përgjegjësia e përputhshmërisë

Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale, detajet e kontaktit të të cilit ndodhen në fund të këtyre Rregullave, është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të mbrojtjes së të dhënave personale dhe përputhshmërinë me këto Rregulla.

Njerëzit në pozicione drejtuese janë përgjegjës për të siguruar që anëtarët e ekipeve të tyre të respektojnë rregullat e mbrojtjes së të dhënave personale.

3. Përgjegjësia jonë

Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave parashikon gjopa të larta për organizatat që shkelin dispozitat e saj. Në varësi të llojit të shkeljes, organizatat mund të paguajnë një gjobë deri në 20 milionë euro, ose 4% të xhiros totale vjetore në nivel botëror për vitin e fundit financiar.

4. Përkufizime

Të dhënat nga dosjet penale i referohen veprave penale të kryera nga një person dhe dënimeve.

Kontrollorët janë persona ose organizma të cilët përcaktojnë qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale. Është detyrë e tyre të vendosin praktika dhe rregulla që do të jenë në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Furnizuesit, konsulentët dhe kontraktorët tanë mund të jenë gjithashtu kontrollues.

Subjektet, në kuptimin e këtyre Rregullave, nënkuptojnë të gjithë individët të dhënat personale të të cilëve ne i zotërojmë, përfshirë blerësit aktualë, të kaluar dhe të mundshëm, furnitorët, agjentët, investitorët dhe anëtarët e stafit tonë. Të gjithë subjektet e të dhënave kanë të drejta ligjore në lidhje me të dhënat e tyre personale.

Të dhënat personale janë të dhëna që kanë të bëjnë me një individ të gjallë, identiteti i të cilit mund të përcaktohet në bazë të atyre të dhënave (ose në bazë të atyre dhe të dhënave të tjera që zotërojmë). Të dhënat personale mund të jenë fakte (për shembull, emri, adresa ose data e lindjes) ose opinione (për shembull, vlerësimi i performancës së punës).

Përpunimi është çdo procedurë që përfshin përdorimin e të dhënave personale. Përfshin marrjen, përdorimin, shikimin, aksesin, regjistrimin ose zotërimin e të dhënave ose kryerjen e një veprimi ose grupi veprimesh në lidhje me të dhënat, duke përfshirë organizimin, korrigjimin, rikthimin, përdorimin, shpërndarjen, fshirjen ose shkatërrimin e tyre. Përpunimi gjithashtu nënkupton transferimin e të dhënave personale tek palë të treta.

Të dhënat e kategorisë së posaçme (të njohura më parë si të dhëna personale sensitive) përfshijnë të dhëna mbi origjinën racore ose etnike të një personi, bindjet politike, besimet fetare ose të ngjashme, anëtarësimin në sindikata, shëndetin fizik apo mendor ose gjendjen dhe jetën personale intime dhe të dhëna gjenetike e biometrike për qëllime të identifikimit personal.

5. Parimet e Rregullores për Mbrojtje të Përgjithshme të të Dhënave

Çdokush që përpunon të dhëna personale duhet të veprojë në përputhje me parimet e zbatueshme të praktikave të mira të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, të cilave Samsung do t'i përmbahet në mënyrat e mëposhtme:

- Ne do t'i përpunojmë të dhënat personale ligjërisht, në mënyrë të paanëshme dhe transparente (shihni nën "ligjshmërinë, paanësinë dhe transparencën").

- Ne do t'i grumbullojmë të dhënat personale për qëllime specifike, të qarta dhe të ligjshme dhe nuk do t'i përpunojmë ato në mënyrë që nuk janë në përputhje me këto qëllime (shihni "kufizimin e qëllimit dhe zvogëlimin e të dhënave").
 - Ne do të përpunojmë të dhëna personale që janë të përshtatshme, të rëndësishme dhe të kufizuara me sa është e nevojshme në lidhje me qëllimet për të cilat ato përpunohen (shihni nën "kufizimi i qëllimit dhe zvogëlimi i sasisë së të dhënave").
 - Ne do të sigurojmë që të dhënat personale të jenë të sakta dhe, nëse është e nevojshme, të përditësuara; nëse të dhënat janë të pasakta, ne do të marrim të gjitha masat e arsyeshme për t'i fshirë ose korrigjuar pa vonesë, duke marrë parasysh qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat (shihni "saktësia").
 - Ne do t'i ruajmë të dhënat personale në një formë që mundëson identifikimin e individit me të cilin ato lidhen, vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale (shihni "kufizimin e ruajtjes").
 - Ne do të zbatojmë masat e duhura teknike apo organizative për të garantuar sigurinë e të dhënave personale, duke përfshirë mbrojtjen kundër përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe kundër humbjes, shkatërrimit ose dëmtimit aksidental (shih "integriteti dhe konfidencialiteti").
- Më poshtë vijojnë informacione të mëtejshme për secilin prej këtyre parimeve:

5.1 Ligjshmëria, Paanësia dhe Transparenca

Objekti i ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale nuk është të parandalojë përpunimin e të dhënave personale, por të sigurojë që kjo të bëhet në mënyrë të drejtë dhe pa ndikim negativ në të drejtat e subjektit të të dhënave.

Përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm nëse plotësohet një nga kushtet ligjore të përpunimit. Këto kërkesa ligjore përfshijnë si më poshtë: subjekti i të dhënave ka dhënë shprehimisht dhe lirisht pëlqimin për përpunimin; përpunimi është i përcaktuar me ligj; përpunimi është i nevojshëm për ekzekutimin e kontratës që kemi lidhur me të paditurin; përpunimi është i nevojshëm për qëllimet e interesave legjitime të Samsung ose palës së cilës i janë zbuluar të dhënat (përveç kur këto interesa janë më të forta se ato interesa ose të drejtat ose liritë themelore të një individi). Përpara se të fillojmë përpunimin e të dhënave personale (për shembull, përpara se të mbledhim të dhëna personale nga një individ), ne konsiderojmë arsyet e mbledhjes së të dhënave dhe pse na duhen ato. Ne gjithashtu përcaktojmë bazën ligjore që na lejon të marrim dhe përpunojmë ligjërisht të dhëna.

Nga i padituri, në përputhje me ligjin, kërkohet të japë informacione të caktuara, duke përfshirë (por pa u kufizuar në) sa vijon: kush është kontrolluesi i të dhënave (në këtë rast jemi ne, Samsung Electronics Austria GmbH, Podružnica Zagreb, Zagreb, Radnička cesta 37b, Republika Kroaci); qëllimet për të cilat ne do të përpunojmë të dhënat, bazën ligjore për përpunimin, identitetin e personave të cilëve mund t'u zbulohen ose transferohen të dhënat dhe të drejtat e të paditurve në lidhje me të dhënat e tyre personale. Ky informacion duhet të përmbahet në një njoftim të përshtatshëm të privatësisë së të dhënave ose në një deklaratë të drejtë të përpunimit të të dhënave.

5.2 Kufizimi i qëllimit dhe Zvogëlimi i sasisë së të dhënave

Të dhënat personale mund të përpunohen vetëm për qëllime specifike për të cilat subjekti i të dhënave është informuar gjatë grumbullimit të parë të të dhënave ose për qëllime të tjera të lejuara shprehimisht nga ligji në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo do të thotë që të dhënat personale nuk duhet të mbledhen për një qëllim dhe të përdoren për një tjetër. Nëse është e nevojshme të ndryshohet qëllimi për të cilin përpunohen të dhënat personale, subjekti i të dhënave duhet të informohet mbi qëllimin e ri të mbledhjes së të dhënave, përpara se të fillojë çdo përpunim.

5.3 Saktësia

Të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara. Informacioni i pasaktë ose keqinformues nuk është i saktë dhe për këtë arsye është e nevojshme të ndërmerren hapa për të verifikuar saktësinë e të gjitha të dhënave personale në kohën e mbledhjes së tyre dhe në intervale të rregullta më pas. Të dhënat e pasakta ose të vjetruara duhet të shkatërrohen.

5.4 Kufizimi i ruajtjes

Të dhënat personale duhet të ruhen në një formë që nuk lejon identifikimin e individit me të cilin ato lidhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat mbledhen të dhënat personale. Kjo do të thotë që të dhënat duhet të shkatërrohen ose fshihen nga sistemi ynë kur nuk nevojiten më.

Pas përfundimit të periudhës së ruajtjes, të dhënat që përmbajnë të dhëna personale do të hiqen dhe shkatërrohen në mënyrë të sigurtë, përveç nëse egziston një arsye legjitime biznesi për mbajtjen e tyre përtej kësaj periudhe (për shembull, subjekti i të dhënave ka nisur një çështje kundër nesh dhe ruajtja e të dhënave personale është e rëndësishme për mosmarrëveshjen në fjalë).

5.5 Integriteti dhe Konfidencialiteti

Ne jemi të detyruar të marrim masat e duhura mbrojtëse kundër përpunimit të paligjshëm ose të paautorizuar të të dhënave personale dhe kundër humbjes ose dëmtimit aksidental të tyre.

Ruajtja e sigurisë së të dhënave nënkupton sigurimin e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave personale, të cilat përcaktohen si më poshtë:

- Konfidencialiteti do të thotë që akses tek të dhënat personale kanë vetëm ata persona që janë të autorizuar t'i përdorin ato.
- Integriteti do të thotë që të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të përshtatshme për qëllimet për të cilat përpunohen dhe të besueshme gjatë gjithë jetës së tyre (pra, personat e paautorizuar nuk duhet t'i ndryshojnë këto të dhëna).
- Disponueshmëria do të thotë që përdoruesit e autorizuar kanë mundësinë të aksesojnë të dhënat nëse u nevojiten për qëllimet e miratuara. Prandaj, të dhënat personale duhet të ruhen në sistemin tonë kompjuterik qendror, dhe jo në kompjuterë personalë individualë.

Procedurat e sigurisë përfshijnë:

- Kontrollet në hyrje. Raportimi i një të huaji në ambiente me hyrje të kontrolluar.
- Siguroni tavolinat dhe dollapët. Mbyllja e tavolinave dhe dollapëve nëse në to ruhen informacione konfidenciale të çfarëdo lloji. (Informacionet personale konsiderohen gjithmonë konfidenciale).
- Metodat e shkatërrimit. Dokumentet në formë shkresore duhet të priten. Disketat dhe CD-ROM-të duhet të shkatërrohen fizikisht kur nuk janë më të nevojshme.
- Pajisjet. Anëtarëve të stafit të Samsung u kërkohet të sigurojnë që informacioni konfidencial të mos jetë i dukshëm në ekran për kalimtarët dhe të shkëputet nga kompjuteri kur nuk është në përdorim nga ata.

Samsung u përmbahet të gjitha procedurave dhe përdor të gjitha teknologjitë e disponueshme për të ruajtur sigurinë e të gjitha të dhënave personale, që nga momenti i mbledhjes së tyre deri në shkatërrimin e tyre. Në praktikë, kjo nënkupton sa vijon:

- Mund të aksesohen vetëm të dhënat personale për të cilat ka leje dhe vetëm për qëllimet e miratuara.
- Asnjë personi tjetër (përfshirë anëtarët e tjerë të stafit të Samsung) nuk mund t'i jepet akses në të dhënat personale nëse nuk ka lejen e duhur për ta bërë këtë.
- Të dhënat personale mbrohen, për shembull, duke ndjekur rregullat për hyrjen në ambiente, aksesin në kompjuter, mbrojtjen me fjalëkalim dhe enkriptimin, duke mundësuar ruajtjen e sigurt të të dhënave dhe shkatërrimin e tyre, si dhe masa të tjera sigurie të përcaktuara në rregullat e sigurisë së të dhënave të Samsung.
- Të dhënat personale (përfshirë të dhënat personale në dosje) app pajisjet që përmbajnë të dhëna personale (ose pajisjet që mund të përdoren për të hyrë në të dhënat personale), nuk largohen nga ambientet e Samsung, përveç nëse merren masat e duhura sigurie (për shembull, pseudonimizim, kriptim ose fjalëkalim mbrojtje) për të mbrojtur të dhënat dhe pajisjet.

- e) Të dhënat personale nuk ruhen në një disk lokal ose në pajisje personale që përdoret për qëllime pune.

6. Kategoritë e veçanta të të dhënave personale

Herë pas here mund të na duhet të përpunojmë kategori të veçanta të të dhënave personale.

Ne do të përpunojmë kategori të veçanta të të dhënave personale vetëm kur kemi një bazë ligjore për ta bërë këtë (shih Seksionin 5 të këtyre Rregullave) dhe kur zbatohet një nga kushtet e veçanta për përpunimin e të dhënave të kategorive të veçanta. Kushtet e veçanta përfshijnë, por nuk kufizohen në sa vijon:

- a) Subjekti ka dhënë pëlqimin e shprehur për përpunim.
- b) Përpunimi është i nevojshëm për qëllime të ushtrimit të të drejtave dhe përmbushjes së detyrimeve të Samsung ose të subjektit në fushën e ligjit të punës.
- c) Përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetike të subjektit dhe subjekti është fizikisht i paaftë për të dhënë pëlqimin.
- d) Përpunimi i referohet të dhënave që publikohen qartë nga i subjekti.
- e) Përpunimi është i nevojshëm për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore.
- f) Përpunimi është i nevojshëm për qëllime me interes të rëndësishëm publik.

Kategoritë e veçanta të të dhënave personale nuk do të përpunohen:

- a) derisa të kryhet një vlerësim i ndikimit të grumbullimit;
- b) derisa personi të cilit i referohen të dhënat personale të njoftohet në mënyrën e duhur (me anë të një deklarate të privatësisë ose në një mënyrë tjetër) për natyrën e përpunimit, qëllimet për të cilat dhe bazën ligjore mbi të cilën kryhet.

7. Shpërndarja e të dhënave personale (përfshirë transferimin e të dhënave jashtë EEA)

Të dhënat personale mund t'i transferohen vetëm një pale të tretë si ofrues shërbimi që pranon të respektojë rregullat dhe procedurat e nevojshme dhe përmbush të gjitha dispozitat përkatëse kontraktuale që ne kërkojmë prej saj dhe që pranon të zbatojë masat e duhura sipas kërkesës.

Të dhënat personale mund të ndahen me një anëtar tjetër të stafit të grupit tonë (i cili përfshin filialet tona dhe kompaninë tonë mëmë së bashku me filialet e tij) vetëm nëse marrësi ka nevojë për të dhëna të tilla për qëllime biznesi dhe transferimi përputhet me kufizimet e zbatueshme të transfertave ndërkufitare (shih në vazhdim).

Legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave kufizon transferimin e të dhënave në vendet jashtë Zonës Ekonomike Evropiane ("EEA") në mënyrë që të mos cenohet niveli i kërkuar i mbrojtjes së të dhënave. Të dhënat personale me origjinë nga një vend transferohen përtej kufirit nëse dorëzohen, dërgohen, inspektohen ose aksesohen në një vend tjetër. Përpara transferimit ndërkufitar të të dhënave personale, do të kontrollohet nëse janë plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme.

8. Krijimi i profilit dhe vendimarrja e automatizuar

Ekzistojnë kufizime të rëndësishme lidhur me rrethanat në të cilat është e mundur të merret një vendim i automatizuar për individët (është një vendim që merret ekskluzivisht automatikisht, pa asnjë ndërhyrje njerëzore). Kjo vlen edhe për krijimin e një profili (ky është përpunimi i automatizuar i të dhënave personale për vlerësimin e disa aspekteve që lidhen me individin, për shembull nëse individi do të ishte i interesuar për produkte të caktuara).

Kjo lloj vendimarrjeje është e mundur vetëm për qëllime të zbatimit të kontratës, kur kjo lejohet me ligj apo nëse individi ka dhënë pëlqimin e tij të shprehur. Individët kanë të drejtë të marrin informacion në lidhje me vendimarrjen dhe kanë të drejta të caktuara për informim, përfshirë të drejtën për të kërkuar ndërhyrje njerëzore ose të drejtën për të apeluar një vendim, dhe për këtë lloj vendimarrjeje ka gjithashtu kufizime strikte lidhur me përdorimin e kategori të posaçme të të dhënave personale.

Çdo veprimtari profilizimi do të kryhet në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

9. Marketingu i drejtpërdrejtë

Ekzistojnë kërkesa strikte për mbrojtjen e të dhënave personale lidhur me marketingun e drejtpërdrejtë që synon klientët tanë dhe ne ndjekim gjitha udhëzimet e zbatueshme ndaj nesh.

10. Mbajtja e regjistrave

Është e rëndësishme që ne të mund të provojmë se jemi në përputhje me parimet e përpunimit të të dhënave personale. Si dhe, kur është e nevojshme, ne ruajmë të dhëna të përshtatshme mbi trajtimin e të dhënave personale. Mund të përfshijë të dhëna të bazës ligjore bazuar në të cilën ne i përpunojmë të dhënat personale, regjistrimet e të dhënave të dërguara të anketuarve dhe të dhënat e përpunimit tonë të të dhënave personale.

11. Të drejtat e subjektit të të dhënave

Të dhënat personale përpunohen në përputhje me të drejtat e subjekteve të të dhënave. Subjektet e të dhënave kanë të drejtat e mëposhtme:

- a) Nëse ata kanë dhënë pëlqimin e tyre për përpunim, ata mund ta tërheqin këtë pëlqim në çdo kohë (kjo duhet të jetë aq e thjeshtë sa dhënia e tij).
- b) Ata kanë të drejtën për të pasur informacion të qartë, transparent dhe lehtësisht të kuptueshëm mbi mënyrën se si përdoren të dhënat e tyre personale (pikërisht për këtë arsye ne ofrojmë një deklaratë të privatësisë së të dhënave).
- c) Ata kanë të drejtë të kërkojnë akses në të gjitha të dhënat që kontrolluesi i të dhënave zotëron në lidhje me ta.
- d) Ata kanë të drejtë të kërkojnë ndryshimin dhe korrigjimin e të dhënave të pasakta.
- e) Ata kanë të drejtë të kërkojnë fshirjen e të dhënave lidhur me ta, të cilat janë në zotërim të kontrolluesit, nëse plotësohen disa kushte të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- f) Kanë të drejtë të kërkojnë kufizim të përpunimit nëse plotësohen disa kushte të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- g) Ata kanë të drejtë të kërkojnë transferimin e të dhënave te një kontrollues tjetër i të dhënave personale, nëse plotësohen disa kushte të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- h) Ata kanë të drejtë të paraqesin një kundërshtim lidhur me përpunimin e të dhënave te tyre personale, nëse plotësohen disa kushte të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.
- i) Ata kanë të drejtë të mos i nënshtrohen një vendimi të bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar, përfshirë profilizimin, i cili prodhon efekte juridike në lidhje me ta ose në mënyrë të ngjashme i prek në mënyrë të konsiderueshme, përveç rasteve kur ata kanë shprehur pëlqimin e tyre për këtë, ose nëse është e nevojshme për lidhjen apo zbatimin e një kontrate me ta.
- j) Ata kanë të drejtë të ankohen pranë Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me përpunimin tonë të të dhënave (të dhënat e kontaktit gjenden më poshtë), megjithëse ne do të dëshironim ta inkurajojmë subjektin e të dhënave që të na kontaktojë fillimisht neve në rast të ndonjë shqetësimi, në mënyrë që të mund të përpiqemi të gjejmë zgjidhje për çështjen në fjalë.

Nëse subjekti dëshiron të ushtrojë ndonjë prej të drejtave të tij, ai duhet të kontaktojë Zyrtarin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Mund të jetë e nevojshme të merren hapat e duhur për të përcaktuar identitetin e personit që paraqet kërkesën.

Kërkesa zyrtare e subjektit të të dhënave (kërkuesit) për dhënie aksesit tek të dhënat personale që lidhen me të e të cilat janë në posedim të degës së Zagrebit të Samsung Electronics Austria GmbH, mund të dorëzohet me shkrim. Megjithatë, kërkesa e subjektit të të dhënave për akses tek të dhënat e tij personale nuk duhet të jetë domosdoshmërisht zyrtare dhe as nuk duhet të dorëzohet me shkrim (qasja në të dhënat personale mund të kërkohet nëpërmjet rrjeteve sociale ose me telefon). Çdo anëtar i stafit që merr një

kërkesë për akses tek të dhënat personale, do t'ia përcjellë kërkesën pa vonesë Oficerit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe/ose Departamentit Ligjor dhe Përputhshmërisë.

Përfshirë në rastet e jashtëzakonshme, Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, do t'i përgjigjet kërkesës brenda 30 ditëve nga marrja e saj. Nëse Samsung nuk do të jetë në gjendje të sigurojë të dhënat personale të kërkuara, arsyet për këtë do të dokumentohen plotësisht dhe subjekti i të dhënave do të njoftohet me shkrim. Subjektit të të dhënave do t'i sigurohet gjithashtu informacion mbi autoritetin mbikëqyrës kompetent, tek i cili mund të drejtohet ankesa, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

12. Shkelja e të dhënave personale

Shkelja e të dhënave personale është një shkelje e sigurisë që rezulton në shkatërrim aksidental ose të paligjshëm, humbje, ndryshim, shpërndarje e paautorizuar ose akses tek të dhënat personale që janë transmetuar, ruajtur ose përpunuar ndryshe. Një shkelje nuk përfshin domosdoshmërisht shpërndarjen e të dhënave personale tek një burim i jashtëm pa lejen e nevojshme, por mund të nënkuptojë që dikush ka akses tek këto të dhëna, pa lejen e nevojshme.

Ne jemi të detyruar të raportojmë disa forma shkeljeje tek autoriteti rregullator kompetent dhe në një numër të kufizuar rastesh edhe tek vetë subjektet e të dhënave.

Ne do të njoftojmë pa vonesë Shërbimin e Sigurisë të zyrës qendrore evropiane të Samsung, Oficerin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Degës së Samsung Electronics Austria GmbH në Zagreb dhe/ose Departamentin Ligjor dhe Departamentin e Monitorimit të Përputhshmërisë, në rast të shkeljes së të dhënave personale ose në rast shkeljeje të dyshuar, në mënyrë që ata mund të ndërmarrin masat e nevojshme ose, nëse është e nevojshme, ta përcjellin çështjen më tej.

13. Autorizimi për të hyrë në të dhëna

Qasja në të dhënat e mbledhura dhe/ose të përdorura nga Samsung Electronics Austria GmbH, Dega e Zagrebit u jepet vetëm personave të mëposhtëm:

- Të dhënat personale rreth klientëve të mbledhura përmes faqeve të internetit të krijuara për qëllime të caktuara marketingu:

- Për përfaqësuesit ligjorë të Samsung Electronics Austria GmbH Dega Zagreb
- Punonjësit e marketingut, detyrat e të cilëve përfshijnë trajtimin e të dhënave personale të mbledhura për qëllime specifike marketingu

14. Përditësimi i Rregullave

Departamentet e Burimeve Njerëzore, Ligjore dhe Pajtuëshmërisë janë përgjegjëse për mirëmbajtjen, rishikimin dhe përditësimin e rregullt të këtyre Rregullave. Ju do të njoftoheni për përditësimet dhe ndryshimet në këto Rregulla nëpërmjet tabelës së buletinit dhe/ose me email.

15. Informacion i dobishëm kontakti

Lidhur me çështje të mbrojtjes së të dhënave personale, mund të kontaktoni adresat e mëposhtme:

Dega në Zagreb e Samsung Electronics Austria GmbH

Radnička cesta 37b, Zagreb, Republika e Kroacisë

Adresa e E-mailit: Na kontaktoni tek dataprotection.sead@samsung.com